

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7886  
E enjte, 19 shtator 2024  
Çmimi 0.50

## Begaj: Kosova të anëtarësohet në Kartën e Adriatikut, i sjell siguri rajonit

FAQE 4



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## GRENELLI: S'NDIHEM MIRË QË THAÇI ËSHTË NË BURG, DO TA LIROJMË NËSE FITON TRUMPI

FAQE 4-5



Ish-emisari amerikan për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka thënë se nuk dihet aspak mirë që ish-presidenti Hashim Thaçi ndodhet në burg. Ai ka thënë se

Thaçi ndodhet në Hagë për shkak se ish-administrata e Donald Trumpit e kishte ftuar në ShBA. Në këtë kontekst, Grenelli ka thënë se nëse Trumpi do të zgjidhet

president i ShBA-së, Thaçin do ta lirojnë nga burgju. "Mezi pres që presidenti Trump të fitojë, sepse do ta nxjerrim Thaçin nga burgju", ka thënë Grenelli

### AKTUALE



**BRITANIA DISLOKON TRUPA SHITESË NË KOSOVË PËR STËRVITJE ME KFOR-in** F. 5

**KONJUFCA DHE SHEFI I EULEX-it DISKUTOJNË PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E SUNDIMIT TË LIGJIT** F. 6

**PACIENTËT NË OKUK, NË LISTA PRITJESH NGA VITI 2020** F. 7

### EKONOMI



**HOTI KRITIKON QEVERISJEN LV - GUXO PËR REFORMAT FISKALE: QEVERIA E ARDHSHEME KA SHUMË PUNË PËR SANIMIN E DËMEVE** F. 8

**BERZH-i DHE BE-ja ZGJEROJNË MBËSHETJEN PËR NËDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME** F. 8

### KRASNIQI: KURTI E KA MJESHTRI PROPAGANDËN

F. 5



### OSMANI: NËSE DIKUSH BËN DIALOG ME SERBINË PËR URËN E IBRIT, SHKEL SOVRANITETIN DHE KUSHTETUTËN

F. 5



### SPORT



**KB TREPÇA FITON NDESHJEN E PARË NË LIGËN E KAMPIONËVE** F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Gjykata e BE-së anulon gjobën prej 1.5 miliard eurosh ndaj "Google"

**LUKSEMBURG, 18 SHTATOR** - Një gjykatë e Bashkimit Evropian ka anuluar një gjobë prej 1.49 miliard eurosh të vënë nga Brukseli kundër gjigantit teknologjik amerikan, "Google", për abuzim të dominimit në fushën e reklamave online. "Gjykata e përgjithshme anulon vendimin e Komisionit Evropian në tërësinë e tij", ka thënë gjykata me seli në Luksemburg, nëpërmjet një komunikate, duke shtuar se "institucioni kreu gabime gjatë shqyrtimeve". Brukseli ka "dështuar të marrë në konsideratë të gjitha rrethanat relevante në shqyrtimin e



kohëzgjatjes së klauzoleve të kontratave që Komisioni i kishte cilësuar abuzive", ka thënë gjykata. Komisioni Evropian, rregullator

me ndikim i konkurrencës në BE, ka thënë se "do të studiojë me kujdes gjykimin dhe do të reflektojë për hapat e mundshëm

të radhës" – që mund ta përfshijnë edhe apelin.

Gjykimi do të lehtësojë "Google", pasi gjykata më e lartë e BE-së javën e kaluar konfirmoi një gjobë të vënë ndaj kompanisë më 2017, me vlerë prej 2.42 miliardë eurosh, për abuzim të dominimit përmes favorizimit të shërbimit të saj për krahasimin e ofertave.

Si pjesë e një nisme të madhe për t'i luftuar abuzimet e gjigantëve të teknologjisë, BE-ja ka ndëshkuar "Google"-n me gjoba që kapin vlerën e përgjithshme të 8.2 miliardë eurove, ndërmjet viteve 2017 dhe 2019, për shkak të shkeljeve të ligjeve të

konkurrencës.

Gjopa prej 1.49 miliard eurosh është e treta nga këto ndëshkime, e fokusuar ndaj shërbimit "AdSense" të "Google". Por, betejat e gjata ligjore ndërmjet "Google" dhe BE-së nuk përfundojnë këtu.

"Google" është duke sfiduar edhe një gjobë prej 4.3 miliardë eurosh që Brukseli ia ka shqiptuar për shkak të vënies së kufizimeve në telefonat me sistemin Android, për ta favorizuar biznesin e saj të kërkimeve në internet.

Gjopa e 2018-s mbetet më e larta e shqiptuar ndonjëherë nga BE-ja për shkelje të ligjeve të konkurrencës.

## Evropa Qendrore në garë me kohën kundër vërshimeve

**VROCLAV, 18 SHTATOR** - Vullnetarë dhe punonjës të shërbimeve emergjente kanë punuar gjatë natës ndërmjet të martës dhe të mërkurës për ta fortifikuar qytetin polak Vroclav përballë rrezikut të vërshimeve si rezultat i niveleve të ngritura të ujit, ndërsa Hungaria ka hapur një digë teksa kryeministri ka paralajmëruar për afrimin e një "periudhe kritike". Përmbytjet më të ashpra që kanë goditur Evropën Qendrore në dy dekadat e fundit kanë shkakuar dëme të mëdha nga Rumania deri në Poloni, duke përfshirë baltë dhe mbetje nëpër vendbanime, duke shkatërruar ura, duke fundosur automjete dhe duke i lënë autoritetet dhe amvisëritë me dëme që do ta arrijnë vlerën e

miliarda dollarëve.

"Shumëçka ka ndodhur sonte", ka thënë kryeministri polak Donald Trusk gjatë një mbledhjeje për menaxhimin e krizës në Vroclav. "Na duhen informata urgjente... nga ato vende ku është ngritur niveli i ujit".

Qytezat në jug të Vroclavës, si Levin Bzheski, tashmë janë goditur nga vërshimet, që kanë detyruar banorët të dalin nëpër rrugët e përmbytura apo të kërkojnë vende të sigurta në çatitë e shtëpive apo ndërtesave, raporton "Reuters".

Në Hungari autoritetet hapën një digë në veriperëndim të vendit, për ta kanalizuar ujin nga lumi Lajta në një rezervuar emergjent, në përpjekje për ta mbrojtur



qytetin Mosonmaxharovar. Në kryeqytetin Budapest, uji i Danubit pritet të arrijë në nivelin e 8.5 metrave apo ta kapërcejë atë,

dikur gjatë të premtës apo të shtunës. "Për shkak të shiut të rrëmbyeshëm dhe përmbytjeve, situata është kritike në mbarë

Evropën Qendrore. Sipas parashikimeve të fundit, periudha kritike për Hungarinë do të nisë nesër (e mërkurë), prandaj po bëhen përgatitje maksimale për mbrojtje nga përmbytjet", ka thënë kryeministri hungarez, Viktor Orban.

Disa shtete evropiane janë përballur me vërshime vdekjeprurëse gjatë fundjavës, teksa Rumania, Polonia, Austria dhe Çekia kanë raportuar për viktima dhe dëme të mëdha. Dy ditë pasi shiu i rrëmbyeshëm ka përmbytur dy qarqe në lindje të Rumanisë, shumë zona kanë mbetur të mbuluara nga uji, ndërsa njerëzit janë duke u përballur me vështirësi në logaritjen e dëmeve.

## Trumpi i rikthehet fushatës pas përpjekjes së dytë për vrasjen e tij



**UASHINGTON, 18 SHTATOR** - Kandidati republikan për president të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, u është kthyer aktiviteteve të fushatës zgjedhore për herë të parë që prej një përpjekjeje të dytë për vrasjen e tij.

Trumpi është lavdëruar më 17 shtator se "vetëm presidentëve të rëndësishëm iu bëhet atentat", teksa ka përshëndetur kundërshtaren e tij, kandidaten demokrate Kamala Harris, për kujdesin e treguar përmes një

telefonate, raporton "AFP".

Ish-presidenti amerikan ka folur në një tubim para mbështetësve të zjarrtë në Flint, një qytet industrial që dikur ishte qendër e industrisë automobilistike amerikane në qytetin e luhatshëm të Miçiganit, para se fabrikat të mbylleshin për shkak të konkurrencës së jashtme. Trumpi është munduar të lidhë atë që Byroja Federale amerikane e Hetimeve (FBI) e ka cilësuar si përpjekje të penguar për vrasjen e tij të dielën, në fushën e tij të golfit në Florida, me zotimin e tij për të

vendosur tarifa të larta ndaj importit të automjeteve nga Meksika dhe nga Kina.

"Dhe pastaj habiteni pse sulmohem me armë... E dini që vetëm presidentëve të rëndësishëm iu bëhet atentat", është shprehur ai. Kandidati republikan ka thënë se njeriu që dyshohet se është përpjekur ta vraste atë ishte ndjekës i asaj që ai e ka quajtur retorikë e presidentit Joe Biden dhe e Harrisit që ngulmon se Trumpi përbën rrezik për demokracinë amerikane.

## Shtetet fqinje në alarm: Koreja e Veriut teston raketa balistike

**PHENIAN, 18 SHTATOR** - Koreja e Veriut ka testuar të mërkurën disa raketa balistike drejt deteve të saj lindore, thanë ushtritë koreane-jugore dhe japoneze, duke shtuar demonstrimet e saj ushtarake, ndërsa tensionet me Uashingtonin dhe fqinjët

përshkallëzohen.

Nisjet vijnë disa ditë pasi Koreja e Veriut ka ofruar një pamje të rrallë në një objekt të fshehtë të ndërthuar për ta pasuruar uranin për bomba bërthamore, ndërsa udhëheqësi Kim Jong Un ka bërë thirrje për një zgjerim të

shpejtë të programit të tij të armëve bërthamore.

Shefat e shtabit të përbashkët të Koresë së Jugut kanë thënë se kanë zbuluar se Koreja e Veriut qëllonte raketa të shumta balistike me rreze të shkurtër veprimi nga veriu i kryeqytetit të saj, Pheniani,

dhe ka thënë se ata kanë udhëtuar rreth 400 kilometra, ndërsa fluturonin në drejtim të verilindjes, raporton "Associated Press".

Shefat e përbashkët kanë thënë se ishin duke komunikuar ngushtë me Shtetet e Bashkuara dhe



Japoninë gjatë analizimit të nisjeve, por nuk dhanë menjëherë detaj të mëtejshëm të fluturimit.



# Grenelli: S'ndihem mirë që Thaçi është në burg, do ta lirojmë nëse fiton Trumpi

Ish-emisari amerikan për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka thënë se nuk dihet aspak mirë që ish-presidenti Hashim Thaçi ndodhet në burg. Ai ka thënë se Thaçi ndodhet në Hagë për shkak se ish-administrata e Donald Trumpit e kishte ftuar në ShBA. Në këtë kontekst, Grenelli ka thënë se nëse Trumpi do të zgjidhet president i ShBA-së, Thaçin do ta lirojnë nga burgju. "Mezi pres që presidenti Trump të fitojë, sepse do ta nxjerrim Thaçin nga burgju", ka thënë Grenelli



PRISHTINË, 18 SHTATOR - Ish-emisari special presidencial amerikan për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka thënë se ka punuar me kryeministrin Albin Kurti dhe ka potencuar se problemi me liderin e Lëvizjes Vetëvendosje është se "është në mënyrë konstante anti-amerikan". "Ai është tani lideri i Kosovës që është kritikuar nga e gjithë bota, nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Shtëpia e Bardhë e drejtuar nga Bideni, nga BE-ja, gjermanët dhe Franca", ka thënë Grenelli në një intervistë. Ai është pyetur edhe për prokurorin amerikan Jack Smith, që ka lëshuar fletarrestim për ish-presidentin Hashim Thaçi dhe që më pas ka lënë Zyrën e Prokurorit të Specializuar në Hagë dhe është kthyer në ShBA për ta ndjekur

penalisht ish-presidentin amerikan Donald Trump. Grenelli ka thënë se fletarrestimi për Thaçin është lëshuar në kohën kur po bëhej progres sa i përket dialogut Kosovë - Serbi dhe kur ish-presidenti i Kosovës ishte ftuar në Uashington. Grenelli ka thënë se Smith e kishte targetuar Thaçin dhe, sipas tij, fakti që ish-presidenti i Kosovës vazhdon të qëndrojë në burg, është një mizori. Ish-emisari amerikan, që është përfolur se mund të emërohet edhe sekretar i Shtetit në rast të një fitoreje të Trumpit në zgjedhjet e nëntorit, ka thënë se s'ndihet mirë për faktin që Thaçi gjendet në burg, meqë arrestimi i tij ndodhi pasi u ftua që të udhëtojë drejt ShBA-së për marrëveshjen e Uashingtonit.

Grenelli ka thënë se e ndien që duhet të bëjë diçka për të nxjerrë nga burgju dhe ka thënë se mezi pret që Trumpi të fitojë sepse do ta lirojnë ish-presidentin Hashim Thaçi nga burgju. "Çfarë unë besoj, është që kur ne ishim duke bërë progres, Jack Smith ishte në Hagë atë kohë, targetoi presidentin Thaçi. Tani presidenti Thaçi vazhdon të jetë

në burg dhe kjo është një mizori. Për mua është një mizori. S'ndihem mirë për një situatë të tillë, sepse ne e ftuam që të vijë në ShBA të negociojë dhe ai u penalizua dhe shkoj në burg për këtë. Unë e ndiej që duhet të bëjë diçka që të nxjerr nga burgju dhe kam provuar dhe mezi pres që presidenti Trump të fitojë dhe sepse do ta nxjerrim Thaçin nga

burgju", ka thënë Grenelli. Hashim Thaçi së bashku me Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin ndodhen në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar në prill të vitit 2023. Ata janë deklaruar të pafajshëm në raport me akuzat me të cilat është duke i ngarkuar Gjykata Speciale.

## 11 dëshmitarë më pak kundër Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

HAGË, 18 SHATOR - Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Hagë ka shkurtuar sërish listën e dëshmitarëve në rastin e liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Ky vendim është marrë pas urdhrimit të trupit gjykues në mënyrë që procesi gjyqësor të shkurtohet sa më shumë.

Prokuroria e Hagës tash ka larguar nga lista e dëshmitarëve edhe 11 persona, kurse dëshmitë e shtatë dëshmitarëve të tjerë do të pranohen me shkrim. "Prokuroria e Specializuar nuk synon më të mbështetet në dëshmitë e njëmbëdhjetë (11) dëshmitarëve në vijim: [Redaktuar]. Përveç kësaj, ZPS-ja synon t'i dorëzojë me shkrim dëshmitë e shtatë (7) dëshmitarëve të mëposhtëm, në vend që t'i thërrasë ata për të dëshmuar", ka njoftuar Gjykata Speciale.

Prokuroria e Hagës është zotuar se do të vazhdojë edhe më tutje ta reduktojë listën e dëshmitarëve, duke synuar që rastin e saj ta përfundojë në prill të vitit 2025. "Prokuroria e Specializuar do të vazhdojë të shqyrtojë dhe, sipas rastit, ta rregullojë paraqitjen e rastit. Në mënyrë të veçantë, duke marrë parasysh, ndër të tjera, dëshmitarët e ardhshëm (dhe



duke iu nënshtruar vendimeve për mocionet e provave), parashikohet që ZPS të jetë në gjendje të njoftojë të paktën shtatë ndryshime shtesë në listën e saj të dëshmitarëve më 1 nëntor 2024", është thënë në njoftim. Vetëm pak ditë më parë Prokuroria e Hagës ka vendosur për të tjerë dëshmitarë që dëshmitë e tyre të merren me shkrim. Edhe 10 dëshmi nga dëshmitarët

në rastin e liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë janë pranuar me shkrim. Kështu ka konfirmuar Gjykata Speciale në një komunikatë për medie. Kjo gjykatë ka theksuar se për këtë fakt nuk ka pasur kundërshtime nga palët. "Më 10 shtator trupi gjykues pranoi në prova dëshmitë dhe provat materiale shoqëruese me shkrim të 9 dëshmitarëve. Trupi gjykues hodhi poshtë kërkesën në lidhje

me dëshmitarin e 10, pa parajgykuar të drejtën e Prokurorisë për të paraqitur kërkesë për ta thirrur dëshmitarin të dëshmojë në sallën e gjyqit", është thënë në njoftim. Për tre dëshmitarë të tjerë është pranuar kërkesa që të dëshmojnë me video-lidhje. "Të njëjtën ditë, trupi gjykues miratoi një kërkesë të Prokurorisë që dhe dy dëshmitarë të tjerë të japin dëshmi nëpërmjet

videokonferencës, meqë kjo është më e favorshme për shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Trupi gjykues u bind se dhënia e dëshmisë prej tyre nëpërmjet videokonferencës nuk do t'u shkaktojë dëm të akuzuarve dhe është në përputhje me mbrojtjen e efektshme të të drejtave të tyre". "Në çështjen gjyqësore Thaçi të tjerët, më 5 shtator, Trupi Gjykues miratoi kërkesën e Prokurorisë për ta lejuar pranimin në prova të disa pjesëve të dëshmisë me shkrim të një dëshmitari dhe për ta lejuar atë të dëshmojë nëpërmjet videokonferencës. Trupi gjykues theksoi se mbrojtja nuk kundërshtoi kërkesën dhe konstatoi se dhënia e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës është më e favorshme për mirëqenien e dëshmitarit dhe ndihmon në kryerjen e shpejtë të procesit gjyqësor", ka njoftuar Specialja.

Marrja e dëshmimeve me shkrim dhe shkurtimi i kohës së marrjes në pyetje të dëshmitarëve në seancë ka qenë kërkesë edhe e gjyqtarëve me qëllim që të shkurtohet koha. Tre muaj më parë prokurori nga Prokuroria e Specializuar kishte thënë se do të përpiqen ta shkurtojnë kohën. 10 dëshmitarë ishin larguar totalisht nga lista e dëshmitarëve të prokurorisë, kurse 13 të tjerë dhanë dëshmitë e tyre vetëm me shkrim. Fillimisht, ZPS-ja kishte bërë me dije se do t'i ftojë për dëshmi mbi 300 dëshmitarë.



## 27th US-ADRIATIC CHARTER CHIEFS OF DEFENSE CONFERENCE



# Begaj: Kosova të anëtarësohet në Kartën e Adriatikut, i sjell siguri rajonit

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka kërkuar që Kosova të anëtarësohet në Kartën e Adriatikut. Ai ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në këtë mekanizëm forcon jo vetëm sigurinë e saj, por edhe të gjithë rajonin e Ballkanit. “Anëtarësimi i Kosovës në këtë kartë është thelbësor jo vetëm për sigurinë e Kosovës, por edhe për stabilitetin e gjithë rajonit. Kosova ka treguar përkushtim ndaj paqes dhe përbën një faktor kontribuues për sigurinë e Ballkanit Perëndimor”, ka thënë Begaj

EPOKA  
ERE

Lirim GECI

**TIRANË, 18 SHTATOR** - Në edicionin e 27 të Konferencës së Kartës ShBA-Adriatik (A5), që është mbajtur në Shqipëri, presidenti shqiptar, Bajram Begaj, ka deklaruar se anëtarësimi i Kosovës në këtë kartë është një hap drejt sigurisë së rajonit të Ballkanit Perëndimor. Në fjalën e tij, Begaj ka theksuar se bota gjendet në konflikte të përgjakshme siç është në Ukrainë dhe në Lindjen e

Mesme, të cilat, sipas tij, “kërkojnë një qasje të bashkuar dhe një angazhim të përbashkët për t’i adresuar ato në një mënyrë efektive dhe të qëndrueshme”. “Ukraina përballet me një agresion të paprecedentë të paligjshëm nga Rusia. Shqipëria ka mbështetur dhe do të vijojë ta mbështesë Ukrainën në bashkëpunim me aleatët strategjikë. Në Lindjen e Mesme që prej një viti kemi përshkallëzim të konfliktit duke krijuar edhe atje një vatër të nxehtë. Këto çështje madhore

kërkojnë një qasje të bashkuar dhe një angazhim të përbashkët për t’i adresuar ato në një mënyrë efektive dhe të qëndrueshme”, ka thënë Begaj. Më tutje, Begaj ka vënë në dukje se Ballkani Perëndimor përballet me sfida në fushën e sigurisë ku, sipas tij, rajoni i brishtë ndaj “ndikimeve të brendshme dhe të jashtme që mund ta destabilizojnë paqen dhe stabilitetin e arritur”. “Rajoni ynë, Ballkani Perëndimor, përballet me sfida me specifike, veçanërisht në fushat e sigurisë. Rajoni ynë

mbetet i brishtë ndaj ndikimeve të brendshme dhe të jashtme që mund ta destabilizojnë paqen dhe stabilitetin e arritur. Tensionet e krijuara, ndërhyrja nga aktorët e tretë dhe kërcënimet ndaj sigurisë kibernetike, kërkojnë bashkëpunim të thelluar ndër vete dhe me partnerët tanë. Historia nuk duhet harruar, ndryshe rrezikojmë t’i përsërisim gabimet”, ka thënë Begaj, duke shtuar se shqiptarët janë faktor konstruktiv në rajon që kanë kontribuar për paqen dhe sigurinë.

Në këtë mënyrë, sipas Begajt, edhe Kosova duhet të anëtarësohet në Kartën e Adriatikut, duke forcuar jo vetëm sigurinë e saj, por edhe të gjithë rajonit të Ballkanit. “Shqipëria do të luajë një rol kyç në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit. Shqiptarët e rajonit

janë një faktor konstruktiv dhe të moderuar duke kontribuar në paqe, në siguri dhe stabilitet. Ata janë dëshmuar si mbështetës të së ardhmes evropiane dhe euroatlantike të rajonit tonë. Në bashkëpunim me aleatët tanë kemi punuar vazhdimisht për ta përçuar sigurinë në rajon dhe për ta promovuar integrimin e Ballkanit Perëndimor në strukturën euroatlantike. Në këtë rrugëtim është me rëndësi të përfshihen edhe anëtarë të rinj që dëshirojnë të anëtarësohen në iniciativën ShBA - Karta e Adriatikut dhe në NATO. Anëtarësimi i Kosovës në këtë kartë është thelbësor jo vetëm për sigurinë e Kosovës, por edhe stabilitetin e gjithë rajonit. Kosova ka treguar përkushtim ndaj paqes dhe përbën një faktor kontribuues për sigurinë e Ballkanit Perëndimor”, ka thënë Begaj.

## Katër deputetë ftohen në Procesin e Berlinit, dy të pushtetit dhe dy të opozitës

**PRISHTINË, 18 SHTATOR** - Kryetarja e Komisionit për Integrimin Evropian, Rrezarta Krasniqi, ka bërë me dije se janë ftuar katër deputetë të Kuvendit të Kosovës në Procesin e Berlinit. Ajo ka treguar se dy deputetë janë nga radhët e pushtetit dhe dy nga radhët e opozitës. “Kemi një ftesë në Procesin e Berlinit me katër deputetë që janë të ftuar. Dy të pozitës dhe dy të opozitës. Nuk ka qenë e specifikuar, por janë katër dhe kanë kërkuar që shumica me qenë pozitë. Unë e kam të specifikuar që shumica

të jenë pozitë, andaj kam caktuar dy pozitë dhe dy opozitë”, ka thënë Krasniqi në mbledhjen e këtij komisioni, ku në rend dite ka qenë raporti i punës për sesionin vjeshtor 2024. Por, mospajtime me këtë ftesë ka pasur deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Time Kadriaj. Sipas saj, kjo është praktikë e re dhe e instaluar nga kjo qeveri. “Në këtë legjislativë është bërë një gabim sepse përfaqësimi duhet të jetë politik. Praktikë parlamentare



janë të kenë përfaqësim politik, pavarësisht a është parti opozitare apo në pozitë. Kjo është praktika më e re e instaluar

nga kjo qeveri. Nëse shkojmë në një udhëtim zyrtar, nëse ka qenë ftesa se duhen dy opozitë dhe dy pozitë, atëherë pajtohem. Nëse

nuk ka të specifikuar në ftesë nuk bën. Nuk shkon ashtu. Është përfaqësim politik”, ka thënë Kadriaj. Ndërsa aktivitetet e këtij sesioni deputetja e AAK-së ka propozuar që të plotësohen sipas nevojës. “Zakonisht plani i punës varet nga agenda legjislativë. Ne si komision nuk e kemi pasur asnjë shqyrtim. Aktivitetet mund të plotësohen dhe koordinohen sipas nevojave. Nuk është plani i punës statik”, është shprehur Kadriaj.



## Krasniqi: Kurti e ka mjeshtri propagandën

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka adresuar kritika të shumta ndaj Qeverisë së Kosovës që udhëhiqet nga kryeministri Albin Kurti. Sipas Krasniqit, Kurti e ka "mjeshtri propagandën", ndërsa qeverisjen "jashtëzakonisht të dobët".

Duke folur për "EO", Krasniqi ka thënë se Kurti nuk i ka plotësuar premtimet e tij, duke përmendur ekonominë "e stagnuar" dhe shëndetësinë e "degraduar". "Fatkeqësisht, krejt ato që i ka premtuar ka mbetur pa i realizuar, duke filluar nga fakti që sot kemi një ekonomi të stagnuar, kemi një shëndetësi të degraduar, një arsim shumë më keq sesa që ka qenë në të kaluarën, kemi mungesë të projekteve infrastrukturore", ka thënë ai.

Ndërsa për çështjen e veriut, Krasniqi ka thënë se është instrumentalizuar nga pushteti aktual. "Asgjë e re nuk ka

ndodhur përveç një ngritje e dozës së populizmit që është bërë faktori kryesor i qeverisë Kurti, i cili, fatkeqësisht, për ne, si për të gjithë ne qytetarët, nuk ka tema me të cilat mund të mburret, nuk ka tema që mund t'i trajtojë dhe të garojë nesër në zgjedhje përveç Veriut të cilën e ka instrumentalizuar si temë për t'i tentuar mashtrimet e qytetarëve të Kosovës", ka thënë ai.

Më tutje, Krasniqi ka përmendur disa prej premtimeve më të rëndësishme të Kurtit, përfshirë ndërtimin e çerdheve dhe autoudhët në Gjilan, Podujevë dhe Mitrovicë. "Prej premtimeve që kanë qenë shumë të popullarizuara të tipit të ndërtimit të 160 çerdheve për një mandat qeverisëse ne në ditët e fundit të këtij mandati nuk besoj që kemi katër çerdhe të ndërtuara. Prej atij premtimi që do të ketë banesa me çmim të përbalueshme për çiftet e reja në mënyrë të veçantë ne sot i kemi çmimet e metrit katror shumë



herë më të shtrenjta sesa kur e ka marrë mandatin. Prej premtimeve që do të ndërtojë autoudhët e pakryera për rrugët Gjilan, Podujevë, Mitrovicë, krejt çka ka mbetur nga projektet

infrastrukturore është ura e famshme e Saradranit dhe, fatkeqësisht, as ura e Badovcit, e cila po u bën kaq shumë telashe të gjithë qytetarëve që udhëtojnë për Anamoravë, as ajo nuk ka

mbërritur të përfundohet, që është një punë që nuk do të duhet të merrte kohë as dy muaj", ka thënë Krasniqi.

Lideri i PDK-së ka folur edhe për zgjedhjet që do të mbahen më 9 shkurt të vitit 2025. "Kemi një kryeministër që me të vërtetë me fjalë ka qenë shumë i mirë, por propagandën e ka mjeshtri, por qeverisjen e ka pasur jashtëzakonisht të dobët, të paftë dhe jo kompetente, për çka besoj se qytetarët tashmë e kanë të qartë se zgjedhjet e 9 shkurtit do të jenë një ballafaqim mes mungesës së kompetencës, vizionit dhe aftësisë për të qeverisur - kombinuar me një propagandë të hatashme siç e kanë pasur dhe e kanë gjithmonë dhe, ndoshta, fakti që ne si PDK nuk jemi propagandues të mirë, nuk dimë të bëjmë një gjë të tillë, por të paktën punën dhe premtimet i kemi realizuar në të kaluarën dhe do t'i realizojmë edhe në të ardhmen", ka thënë Krasniqi.

## Osmani: Nëse dikush bën dialog me Serbinë për urën e Ibrit, shkel sovranitetin dhe Kushtetutën



PRISHTINË, 18 SHTATOR - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka kritikuar qasjen e Brukselit për sa i përket dialogut Kosovë - Serbi. Sipas Osmanit, problemi në dialog është se ka kohë të gjatë që nuk po dëshmon se i njëjti po organizohet në parimin e barazisë së palëve. E para e shtetit ka thënë se për takimin e djeshëm në Bruksel, duhet pyetur kryenegociatorin e Kosovës, Besnik Bislimi, se për çfarë tema është pajtuar. "Për sa iu përket temave, duhet ta pyesni kryenegociatorin se për çfarë tema është dakorduar, pasi në publik është thënë që janë dakorduar për disa tema bashkë me Lajçakun. Nëse dikush bën dialog për urën e Ibrit me Serbinë, kjo është shkelje e sovranitetit, Kushtetutës së Kosovës dhe në asnjë moment nuk është në interes të Kosovës që kjo temë të jetë pjesë e dialogut me Serbinë",

ka thënë Osmani.

Më tutje, Osmani ka thënë se tema e urës së Ibrit duhet të dialogohet me partnerët e sigurisë së Kosovës pasi, sipas saj, edhe vetë marrëveshjet e Brukselit e kërkojnë një gjë të tillë. "Mbi të gjitha, është interes i Kosovës që të punojmë me partnerët tanë të sigurisë, ta kemi këtë plan, i cili pastaj të zbatohet dhe kur të hapet ura, do të jetë vendim i qëndrueshëm që nuk do të mund dhe nuk do të duhej të sfidohej nga askush", ka thënë Osmani. Të martën kryenegociatori i Kosovës në bisedimet me Serbinë, Besnik Bislimi, ka takuar ndihmësekretarin e përgjithshëm të NATO-s për operacione, Tom Goffus dhe komandantin e operacioneve civile në shërbimin e veprimit të jashtëm të BE-së, Sefano Tomat, me të cilët ka biseduar për hapjen e mundshme të urës së Ibrit.

## Britania dislokon trupa shtesë në Kosovë për stërvitje me KFOR-in

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Më shumë se 300 trupa nga Britania e Madhe do të dislokohen në Kosovë për ato që misioni paqeruajtës i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë, KFOR, i ka quajtur ushtrime rutinore. Këto ushtrime do të mbahen nga 18 shtatori deri në fund të tetorit, ka njoftuar KFOR-i nëpërmjet një komunikate, pa dhënë hollësi se në ç'vend do të zhvillohen ato. Kontingjenti britanik, nga Regjimenti Mbrojtësor i Jorkshërit, do të kryejë një sërë aktiviteteve stërvitore, së bashku me trupat e


tjera të KFOR-it, gjatë dislokimit të përkohshëm të tij. KFOR-i ka njoftuar se stërvitjet kanë për qëllim "t'i testojnë procedurat ekzistuese për dislokimin e shpejtë të trupave shtesë dhe integrimin e tyre në kuadër të misionit".

Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë ka bërë me dije, po ashtu, se stërvitjet do ta mbështesin gatishmërinë e KFOR-it "për t'iu përgjigjur zhvillimeve relevante të sigurisë".

Njoftimi për dislokimin e trupave shtesë dhe për stërvitje është bërë

disa javë pasi KFOR-i ka zhvilluar atë që e quajti trajnim mbi urën e Ibrit, që ndan Mitrovicën në jugun e banuar me shqiptarë dhe veriun e banuar me serbë.

Mbi këtë urë, që Kosova po synon ta hapë për qarkullim të automjeteve, KFOR-i ka prani të përhershme. Bashkësia ndërkombëtare u ka kërkuar autoriteteve në Kosovë të përmbahen nga një veprim i tillë tani për tani, ndërkaq misioni i NATO-s dhe Bashkimi Evropian kanë kërkuar që çështja e urës të zgjidhet përmes dialogut.







## KQZ-ja bëhet me logo të re

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur të mërkurën për logon e re të institucionit. Arianit Elshani nga Këshilli për operacione

zgjedhore, i cili është edhe anëtar i KQZ-së nga radhët e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), ka thënë se është një ndryshim i vogël teknik i cili nevojitet për çështje të

fletushkave, broshurave dhe çështje të tjera - posterëve që krijohen nga institucioni që organizon zgjedhjet. “Është një ndryshim i vogël teknik, i cili na nevojitet për çështje të

fletushkave, broshurave dhe çështje të tjera - posterëve që krijohen nga KQZ. Kjo përmbush kërkesën e Këshillit për Operacione Zgjedhore”, ka thënë Elshani.

# Kurti dhe përfaqësuesit e agjencive të OKB-së në Kosovë bisedojnë për avancimin e bashkëpunimit

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti ka bashkëbiseduar të mërkurën me përfaqësues të agjencive të Kombeve të Bashkuara (OKB) në Kosovë në krye me koordinatoren Arnhild Spence. Në njoftimin për medie të zyrës së kryeministrit është bërë me dije se tema të diskutimit ishin prioritetet dhe projektet e qeverisë dhe bashkëpunimi me këto agjenci në avancimin e tyre. Në veçanti është diskutuar për bashkëpunimin në zhvillimin ekonomik përmes mbështetjes ndaj bizneseve e turizmit, sidomos në pjesën veriore të vendit tonë. Po ashtu, është diskutuar për zhvillimin e transportit urban për lidhjen më të mirë ndërmjet lagjeve e qyteteve. Kryeministri i ka informuar të pranishmit rreth punës së shumëllojshme se trevjeçare të qeverisë dhe progresin e arritur i cili është

dëshmuar edhe nga rangimi i Kosovës në indekse e matje ndërkombëtare, duke u udhëhequr mbi parime të demokracisë, mirëqenies sociale, sundimit të ligjit dhe mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët pa dallim. “Përmendi, mes të tjerash, krijimin e 15 mijë vendeve të reja të punës edhe përmes platformës ‘Superpuna’, rritjen e punësimit për gratë, ku me masat e qeverisë u mbështet punësimi i mbi 12 mijë grave. Ai shtoi se edhe në veriu e vendit po punohet për rritjen e vendeve të punës dhe të mundësive të barabarta për të gjithë, përfshirë këtu edhe përfitimet nga programet e efikasitetit të energjisë”, ka njoftuar zyra e kryeministrit. Sipas këtij njoftimi, Kurti ka falënderuar përfaqësuesit e agjencive të Kombeve të Bashkuara për



bashkëpunimin e ngushtë, punën e përbashkët dhe bashkëbisedimin

e frytshëm. Në këtë takim ka marrë pjesë edhe

ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi.

# Qeverisje me ushtrues detyre, Shala: Qeveria Kurti është duke punuar në mënyrë të jashtëligjshme

PRISHTINË, 18 GUSHT - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka kritikuar qeverinë Kurti, konkretisht Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e cila është duke funksionuar me ushtrues detyre. Ai ka se është e habitshme se si një qeveri e tërë është duke punuar jashtëligjshëm. “Kjo ministri, por jo e vetmja, nga sot praktikisht ka dhjetëra sektorë dhe departamente, pozita drejtorësh dhe agjencish, që janë jofunksionale. Çdo vendimmarrje brenda këtyre institucioneve që mbajnë pozita ‘ushtrues detyre’, përkatësisht zëvendësues, nga sot janë krejt të paligjshme, sepse këtë e thotë Ligji nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, kapitulli III, neni 35, ligj ky i cili ka hyrë në fuqi tash



e një vit. Është e habitshme se si një qeveri e tërë punon jashtëligjshëm, e vendimet e kësaj qeverie nga sot për të gjitha pozitat e lartcekura, janë të pavlefshme”, ka shkruar Shala në

“Facebook”, duke treguar se të gjitha dikasteret e MMPHI-së janë duke funksionuar me ushtrues detyre. “Për ta ilustruar këtë shembull të keq-qeverisjes apo paaftësisë qeverisëse, më

lejoni t’ju përmend një listë të ‘ushtruesve’ në këtë qeveri, përkatësisht në këtë ministri: sekretari i përgjithshëm i Ministrisë, ushtrues detyre, drejtori i Agjencisë së Mjedisit, ushtrues detyre, drejtori i Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore, ushtrues detyre, drejtori i Departamentit të Mjedisit, ushtrues detyre, drejtori i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, ushtrues detyre, drejtori i Departamentit për Integritet Evropian, ushtrues detyre. Shihni edhe një fakt të çuditshëm, në pozita shumë të larta, ka raste kur një zyrtar ka ushtruar pozitën e sekretarit të përgjithshëm, pas një periudhe ka kaluar ushtrues detyre në Agjenci të Mjedisit, pastaj pas një periudhe tjetër prapë është kthyer ushtrues

detyre i sekretarit. Pra, kemi të bëjmë me ushtrues të shumëfishtë, ‘ushtrues të ushtruesve’ e manipulime të tilla”, ka shkruar Shala. Më tutje, ai ka thënë se një gjë e tillë është duke ndodhur për shkak të kontrollimit të administratës së kësaj ministrie për qëllime të kundërligjshme. “Për më keq, ka pozita ku ‘ushtruesi’ është emëruar kundërligjshëm, duke kapërcyer shumë ‘shkallë’ nga pozita e zyrtarit, në ushtrues detyre i drejtorit të departamentit. Pse ndodh kjo?! Arsyeja e vetme është që ata të jenë më të ‘dëgjueshëm dhe të kontrollueshëm’ dhe rasti më ilustrativ për dëgjueshmërinë së tyre, është afërsisht tashmë publike e ambalazhuesve të ujit”, ka shkruar Shala.

## Konjufca dhe shefi i EULEX-it diskutojnë për bashkëpunim në fushën e sundimit të ligjit

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të mërkurën në takim shefin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX), Giovanni Pietro Barbano. Në takim është diskutuar për bashkëpunimin midis Republikës së Kosovës dhe EULEX-it sa i përket fushës së sundimit të ligjit, nga perspektiva e aktualitetit dhe synimeve të përbashkëta për

ligjshmëri të kudogjendur, demokraci vibrante dhe stabilitet afatgjatë. Bashkëbiseduesit theksuan gatishmërinë e tyre për bashkëpunim të vazhdueshëm e gjithnjë e më substancial, me qëllim përparimin gjithnjë e më të madh në drejtëm të sundimit të ligjit. Kryetari Konjufca e ka falënderuar Giovanni Pietro Barbano për vizitën, duke e vlerësuar kontributin e

misionit të BE-së në Kosovë. Ai është shprehur se ky kontribut i ka dhënë efektet e tij edhe në kapacitetet e Republikës së Kosovës për t’u përballur me të gjitha sfidat që gjenden përpara. Ndërsa shefi i EULEX-it, Giovanni Pietro Barbano, e ka falënderuar kryetarin Konjufca për pritjen, duke shprehur gatishmëri dhe angazhimin për bashkëpunim gjithnjë e më të thellë në drejtëm të sundimit të ligjit.





# Pacientët në QKUK në lista pritjesh nga viti 2020



PRISHTINË, 18 SHTATOR - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) është e mbingarkuar me rreth 10 mijë pacientë që lëngojnë në lista të pritjes për shërbime thelbësore mjekësore.

Zyra e Auditorit Kombëtar ka gjetur se pjesa më e madhe e tyre endet në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare, pasuar nga Ortopedia, Oftalmologjia, Kardiologjia, Radiologjia dhe Kardiokirurgjia. Pritja mesatare atje arrin në gati tre vjet, sipas raportit të Auditorit, që është publikuar në fund të muajit të kaluar. Auditori e ka hedhur përgjegjësinë te Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK), duke thënë se këto institucione nuk kanë arritur t'i krijojnë kushtet e nevojshme për trajtimin në kohë të pacientëve. Ministria nuk i është përgjigjur kërkesës së "Radios Evropa e Lirë" për koment, ndërsa ShSKUK-ja ka thënë se pritjet e gjata do të vazhdojnë edhe për një kohë. Sipas Auditorit, situatës së tillë i kontribuon mungesa kritike e personelit mjekësor, e sidomos anesteziologëve, e cila çon në shtyrjen e operacioneve.

## Katër vjet pritje

Kujtimin nga Drenasi i është dashur të priste më shumë se tre vjet për të operuar venat në njëren këmbë. "Radio Evropa e Lirë" ka biseduar me ditën kur ishte shtrirë në Kirurgjinë Vaskulare për t'iu nënshtruar operacionit. Se sa urgjent ishte rasti i tij, ka thënë se nuk e dinte, por se "pritja ishte e lodhshme". "Ndoshta do të shkoja në ndonjë institucion privat, por nuk i kisha mundësitë. Sistemit publik, po ashtu, i besoj më shumë", ka thënë ai.

Ndërhyrja në vena në spitalet private në Kosovë kushton së paku një mijë euro, ndërsa në QKUK ky shërbim nuk paguhet.

Në Kirurgjinë Vaskulare të QKUK-së auditori ka gjetur edhe raste të pacientëve të regjistruar në listë të pritjes në janar të vitit 2020, të cilët u operuan në prill të vitit 2024.

Drejtori i klinikës, Hajriz Rudari, ka numëruar dy arsye për këtë: mungesën e anesteziologëve dhe të shtretërve. Rastet që presin më gjatë, sipas tij, janë ato me probleme në vena e që, siç thotë, janë më të lehta. "Në klinikën tonë trajtohen

sëmundje të ndryshme, përfshirë problemet arteriale, problemet venoze, e shtu këtu edhe patologjinë e shputës diabetike. Ne jemi i vetmi vend në Kosovë ku merremi me problemet dhe komplikimet e shputës diabetike. Shputa diabetike kërkon trajtim të gjatë në klinikë dhe (mungesa e shtretërve), përveç mungesës së anesteziologëve - është arsyeja përse krijohet lista të gjata pritjeje", ka thënë Rudari për "Radion Evropa e Lirë".

Në klinikën që udhëheq ai, janë 24 shtretër për të gjitha llojet e patologjive. Sipas stafit, aty mund të pranohen çdo ditë pune nga 24 pacientë, me kusht që ata pacientë të lirohen një ditë pas pranimit. Por, kjo është e pamundur të ndodhë, pasi një pacient qëndron në klinikë, mesatarisht, pesë ditë. Të dhënat e klinikës nga vitet 2019-2023 tregojnë se aty, çdo muaj janë trajtuar mesatarisht 106 pacientë.

## Pse anesteziologët janë problem?

QKUK-ja ka Klinikën e Anesteziologjisë, prej nga specialistët e kësaj fushe

angazhohen në sallat operative dhe jooperative të të gjitha klinikave, e që gjithsej janë 32. Anesteziologjia ka, aktualisht, 48 anesteziologë. Sipas udhëheqësve të saj, numri është i pamjaftueshëm për t'i mbuluar në kohë të gjitha kërkesat. "Vështirësitë shtohen edhe për shkak të angazhimit të tyre në kujdestari të shpeshata - çdo të gjashtën ditë e herë-herë edhe çdo të tretën", ka thënë drejtori Gazmend Spahija për "Radion Evropa e Lirë".

Kjo klinikë prej vitesh përballet me numër të reduktuar të anesteziologëve. Shumë prej tyre kanë kaluar në institucione private ose kanë migruar jashtë vendit, kryesisht në shtete të BE-së. Deri më tash këtë vit janë larguar dy, sipas Odës së Mjekëve të Kosovës, ndërsa në periudhën 2019-2023 janë larguar 29.

Përveç anesteziologëve, janë edhe specialistë të tjerë që largohen nga QKUK-ja. Sipas Odës së Mjekëve, në pesë vitet e fundit janë larguar gjithsej 142.

Nga kjo odë thonë se arsyet e atyre që largohen lidhen me kushtet jo të mira në QKUK dhe pagat, vlera bazë e të cilave silltet rreth 1 200 euro. "Radio Evropa e Lirë" ka arritur të

bjerë në kontakt me një anesteziolog që është larguar para një viti nga QKUK-ja, por nuk ka dashur të identifikohet dhe të jepte hollësi për institucionin ku është i angazhuar tani.

"Për një punë të madhe në QKUK, t'i paguhesh atë sa paguhen edhe të tjerët që bëjnë punë shumë më të vogla", ka thënë shkurtimisht ai.

Në raportin e Auditorit është thënë se ShSKUK-ja, që mbikëqyr QKUK-në dhe shtatë spitalet rajonale të Kosovës, ka zhvilluar gjatë viteve 2019-2023 dy procese të rekrutimit të anesteziologëve. Sipas raportit, atëkohë janë rekrutuar vetëm 23 syresh, që do të thotë se nuk janë zëvendësuar të gjithë mjekët e larguar.

Udhëheqësit e ShSKUK-së kanë thënë se Klinika e Anesteziologjisë ka nevojë për së paku 100 anesteziologë në mënyrë që shërbimet të ofrohen në kohë. Sipas drejtorit Elvir Azizi, mungesa e tyre do të vazhdojë edhe për një kohë.

Vitin e ardhshëm, specializimin në anesteziologji pritet ta përfundojnë mbi 15 mjekë, por se nuk është e sigurt nëse të gjithë ata do të shërbejnë në sistemin publik, sepse disa e kanë vetëfinancuar aftësimin dhe kanë të drejtë të zgjedhin. "Mendoj se me një organizim pak më të mirë mund të ketë përmirësime. Jemi duke punuar në këtë drejtim", ka thënë Azizi në një mbledhje të bordit të ShSKUK-së që është mbajtur javën e kaluar.

Ministria e Shëndetësisë e Kosovës, në bashkëpunim me ShSKUK-në, bën planifikimin e burimeve njerëzore. Por, kjo ministri nuk iu përgjigj pyetjeve të "REL"-it në lidhje me gjetjet e Auditorit.

## Problemet e tjera

Përveç mungesës së anesteziologëve, klinikat me lista të gjata pritjesh kanë edhe mangësi të tjera - oftamologjisë, për shembull, për një kohë i kanë munguar thjerrëzat, ndërsa ortopedisë protezatat. Shërbimi publik shëndetësor i Kosovës përcillet me sfida të tilla që nga paslufta. "Radio Evropa e Lirë" ka raportuar më herët edhe për mungesë të gjërave bazike - nisur nga çarçafët deri te sapunët, apo për të sëmurë me kancer që marrin kimioterapi në salla të improvizuara të QKUK-së. Derisa kritikët flasin për keqmenaxhim janë pacientët ata që bartin barrën e këtyre krizave.

## Zemaj për grevën punëtorëve teknikë të Kuvendit: Heshtje e turpshme, ky problem duhet të trajtohet

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend Zemaj, i ka dalë në mbështetje punëtorëve teknikë të Kuvendit të Kosovës, që janë duke mbajtur grevë në kërkim të rritjes së pagave. Zemaj ka shkruar në "Facebook" se greva e tyre është për dinjitet dhe se trajtimi i tyre është jashtë

njerëzores. Më tutje, Zemaj ka thënë se këtyre punëtorëve nuk u paguhet as trasti dhe as sigurimi shëndetësor. "Grevë për dinjitet! Është i papranueshëm fakti që tash e disa herë punëtorët teknikë të Kuvendit të Kosovës detyrohen të mbajnë grevë, në kërkim të respektimit të minimumit të dinjitetit të tyre, sepse trajtimi i tyre është

jashtë njerëzores, këtyre punëtorëve të vyer me pagë të ulët, nuk u paguhet as trasti, as sigurimi shëndetësor, por as orët shtesë në seancat e gjata me orë të tëra, mos të flasim për punët në vikend", ka shkruar Zemaj, duke shtuar se "udhëheqja e Kuvendit duhet të trajtojë këtë problem, përndryshe është heshtje e turpshme".





## Hoti kritikon qeverisjen LV - Guxo për reformat fiskale: Qeveria e ardhshme ka shumë punë për sanimin e dëmeve

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka kritikuar qeverisjen Vetëvendosje - Guxo për reformat fiskale. Hoti ka thënë se, sipas ligjit të ri për procedurat tatimore, nëse biznesi ka paguar më shumë TVSh në ATK, nuk mund ta shfrytëzojë atë kreditim tatimor mbi tre vjet. "Ja 'reforma fiskale' e qeverisjes LV - Guxo.

Sipas ligjit të ri për procedurat tatimore, nëse biznesi ka paguar më shumë TVSh në administratën tatimore, nuk mund ta shfrytëzojë atë kreditim tatimor mbi tre vjet. Sapo të kalojë periudha trevjeçare ajo shumë e parapagimit tatimor për biznesin është e humbur. Ndërkaq, pagesat e tepërta të tatimit në fitim për periudhën mbi trevjeçare nuk mund të

rimburohen e as të transferohen në obligime të tjera tatimore që biznesi ka ndaj shtetit", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Më tutje, Hoti ka thënë se qeveria e ardhshme ka shumë punë për sanimin e dëmeve të shkaktuar, sipas tij, me ligje e ndërhyrje kontradiktore kundër biznesit dhe parimeve të ekonomisë së tregut të lirë

social. "Ky është rezultati i 'reformave tatimore' kur ato bëhen pa debat publik shterues dhe miratohen me procedura të përsheptuara në Kuvend. Qeveria e ardhshme ka shumë punë për sanimin e dëmeve të shkaktuar me ligje e ndërhyrje kontradiktore kundër biznesit dhe parimeve të ekonomisë së tregut të lirë social", ka shkruar Hoti.



## Protesta, kritika, thirrje: Çfarë po ndodh me Ligjin e Punës?

PRISHTINË, 18 SHTATOR - "Qeveria e Kosovës po mbështet drejtpërdrejt vazhdimin e shkeljeve të të drejtave të grave dhe burrave", ka thënë Brikena Hoxha, drejtoreshë e Iniciativës Kosovare për Stabilitet. Më 16 shtator Hoxha ka lexuar këtë deklaratë të përbashkët të Forumit Ekonomik të Grave gjatë protestës së thirrur kundër mospërfshirjes së Ligjit të Punës në kalendarin legjislativ për vitin 2024.

Nevoja për miratimin e ndryshimeve në Ligjin aktual të Punës është theksuar disa herë nga organizatat joqeveritare.

Këtë vit Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar një raport, ku është thënë se nevoja për ndryshimin e ligjit është urgjente, pasi që "rastet e shkeljeve të të drejtave të punës vazhdojnë me një ritëm alarmues".

Largime arbitrare nga puna, mungesa e kushteve dhe sigurisë në punë, mospagesa e kontributeve pensionale, ekonomia joformale, korrupsioni, mungesa e inspektiveve në terren. Këto listohen si disa nga problemet e shumta që ndikojnë në shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë, ku çdo vit ka disa raste të lëndimeve dhe vdekjeve në vendin e punës. Por, me gjithë tentimet e shumta për ndryshim të Ligjit të Punës, ky ndryshim nuk është përfshirë në programin legjislativ të Qeverisë së Kosovës, të udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti për vitin 2024.

### Katërmëdhjetë vjet tentime të dështuara për ndryshim

Ligji aktual i Punës ishte miratuar në vitin 2010, prej kur Qeveria e



Kosovës nisi t'i rregullonte marrëdhëniet e punës që më parë menaxhoheshin nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

Që nga fillimi ka pasur kritika të shumta për përmbajtjen e këtij ligji. Dy herë ai ishte tërhequr nga rendet ditore të Kuvendit të Kosovës, me arsyetimin se kishte kosto të lartë buxhetore. Herën e tretë ka kaluar pak kohë pasi sindikalistët kanë kërcënuar me mospjesëmarrje në zgjedhje.

Instituti GAP ka publikuar një analizë të Ligjit të miratuar të Punës qysh në qershor të vitit 2011, ku ka listuar disa probleme.

Pushimi i lehonisë ka ngjallur reagimet më të shumta - për shkak të formës dhe buxhetit të ndarë për të - ndjekur nga puna e parapare për Inspektoratin e Punës, i cili kishte numër të pamjaftueshëm inspektorësh.

Pushimi i lehonisë konsiderohej si problem kryesor i këtij ligji qysh në fillimet e tij. Në vitin 2012, Ministria

e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka formuar një grup punues për ta rishikuar pushimin e lehonisë, mirëpo në fund kjo iniciativë ka dështuar.

Qeveritë pasardhëse kanë premtuar ndryshime në Ligjin e Punës - përfshirë në vitin 2019, kur qeveria e udhëhequr nga Ramush Haradinaj e ka çuar atë në Kuvend. Atëkohë është propozuar që pushimi i lehonisë dhe ai prindëror të rregulloheshin me ligj të veçantë. Por, rrëzimi i qeverisë dhe procesi vijues zgjedhor kanë bërë që as këtë herë ligji të mos ndryshohej.

Pastaj, në vitin 2020, kur Lëvizja Vetëvendosje ka marrë pushtetin për herë të parë, Ligji i Punës është përfshirë në agjendën legjislativë dhe është krijuar një grup punues. Por, sërish rrëzimi i qeverisë dhe procesi zgjedhor e kanë ndërprerë këtë proces. Lëvizja Vetëvendosje kishte fituar sërish zgjedhjet në vitin 2021 dhe këtë herë mori pushtetin e vetme, pa pasur nevojë të bëjë koalicion me ndonjë

nga partitë e tjera të mëdha politike.

Ajo sërish e përfshiu Ligjin e Punës në agjendën legjislativë të viteve 2021, 2022 dhe 2023. Madje, në vitin 2022, përveç një Ligji të ri të Punës ishte synuar edhe ndryshimi i Ligjit për Inspektoratin e Punës dhe Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Në tetor të vitit 2022, Vesel Zhinipotoku, drejtor i Departamentit për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore në Inspektoratin e Punës, i ka thënë "REL"-it se "drafti i Ligjit të Punës tashmë është në ministri për të kaluar në procedurat e tjera ligjore". Por, premtimet për ndryshimin e ligjit apo inicimin e një Ligji plotësisht të ri të Punës nuk u konkretizuan as në vitin 2024.

Sipas raportit të KDI-së për Ligjin e Punës, më 2 nëntor të vitit 2023 - gjatë një takimi me Kurtin dhe ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) - Forumit Ekonomik të Grave i ishte thënë se projektligji i punës do të ishte i gatshëm për diskutim publik brenda pak javëve.

"Radio Evropa e Lirë" ka pyetur Qeverinë e Kosovës se pse në fund nuk u përfshi ky projektligj në agjendën legjislativë për vitin 2024, por nuk mori përgjigje.

### Ku çalon Ligji aktual i Punës?

Problemi kryesor shihet te barra që bie mbi shpatullat e bizneseve kosovare për pagesën e pushimit të lehonisë. Punëdhënësi parashihet ta paguajë 70 për qind të pagës së punëtorit për gjashtë muajt e parë, ndërsa qeveria i

mbulon tre muajt e ardhshëm në vlerën prej 50-përqindësh të pagës mesatare. Tre muajt e fundit të pushimit të lehonisë janë pa pagesë. Përveç barrës mbi punëdhënësit, strukturimi i pushimit të lehonisë është kritikuar edhe pasi që nuk jep mundësi që edhe babai të ketë pushim prindëror. Aktualisht, ligji parasheh që babai t'i ketë dy ditë pushim me pagesë dhe e ka opsionin t'i marrë edhe dy javë pushim pa pagesë.

KDI-ja liston edhe disa probleme të tjera në këtë ligj, përfshirë: mbrojtjen e pamjaftueshme për punëtorët me orar të pjesshëm, mungesën e ndëshkimeve për punëdhënësit që nuk regjistrojnë punëtorët qysh në ditën e parë të punës dhe mundësitë që punëdhënësi t'i japë punëtorit kontratë të përkohshme në mënyrë të përsëritur për deri në dhjetë vjet. Ligji kritikohet edhe si i "stërvjetësuar", pasi nuk parasheh trendë të reja, si puna nga shtëpia, puna hibride (nga shtëpia dhe nga zyra) dhe çështja e kontratave të punës për punëtorët e kompanive jashtë shtetit.

Ndryshime në këtë ligj ka rekomanduar edhe Bashkimi Evropian në Raportin e fundit të Progresit, të publikuar në fund të vitit 2023, në mënyrë që ky ligj të jetë në linjë me direktivat e BE-së.

BE-ja ka specifikuar veçanërisht Direktivën për Balancimin mes Punës dhe Jetës, që synon ta përmirësojë pushimin familjar dhe mundëson kushte më fleksibile të punës.

Forumit Ekonomik i Grave ka paralajmëruar që, nëse kërkesat e tij nuk marrin vëmendjen e Qeverisë së Kosovës, "do të reagojë edhe me metoda të tjera", por pa specifikuar se me çfarë.

## BERZh-i dhe BE-ja zgjerojnë mbështetjen për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) ka nisur linjën e re të kredisë për bankat vendase për kreditim të mëtejshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në kuadër të programit "SME GoGreen", me mbështetjen e BE-së.

Financimi i ofruar në kuadër

të programit do t'u dedikohet plotësisht prej investimeve të ekonomisë së gjelbër, duke përfshirë investimet me efikasitet energjetike, energji të rinovueshme dhe efikasitet të resurseve duke kontribuar në reduktimin e gazeve sërë. Sergiy Maslichenko, shef i BERZh-it në Kosovë, ka thënë se agjenda e gjelbër është

ndër prioritetet kryesore të tyre dhe se ky projekt i ndihmon shumë bizneset e vogla dhe të mesme.

Ndërsa ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se ndërmarrjet e mesme dhe të vogla janë boshti kryesor i ekonomisë vendore, duke shtuar se ky program ka ofruar mbështetje

të jashtëzakonshme duke iu mundësuar bizneseve të përafrohen me ato të BE-së.

Në anën tjetër, Johannes Stenbak Madsen, shef i bashkëpunimit në Zyrën e Bashkimit Evropian (BE), ka thënë se BE-ja është përkushtuar për ta përmirësuar përkrahjen e drejtpërdrejtë të bizneseve



dhe se kjo përkrahje do t'i bëjë shumë biznese si të suksesshme.



# Historia e hershme e Sanxhakut dhe ardhja e sllavëve



Përgatiti dhe përktheu:  
Daut DAUTI

Ky libër, *The Sand* ak: A history, është me siguri libri i vetëm dhe më i miri që është botuar në anglisht dhe në gjuhë tjera për Sanxhakun. Si i tillë, ky libër është histori për boshnjakët, shqiptarët, serbët dhe tërë Ballkanin. Më poshtë keni një përkthim nga kapitulli i parë i këtij libri: Historia e hershme e Sanxhakut dhe ardhja e sllavëve. Shenjat më të hershme të banimit të Sanxhakut janë gjetur në shpellën e Smoluçkës në Komunën e Tutinit, që tashti është pjesë e Sanxhakut të Serbisë e që datojnë nga koha e Paleolitit. Në vende të tjera arkeologët kanë zbuluar dëshmi të komuniteteve njerëzore që datojnë nga periudha e hershme e Paleolitit, përafësisht 20 mijë vjet p.e.s., dhe duke vazhduar në

Mezolit (vitet 10 mijë vjet p.e.s.), që janë gjetur në Medena Stijenë (Shkëmbi i Mjaltit) në kanionin e Çehotinës dhe në disa vende tjera afër Plevles në Malin e Zi të sotshëm.

Para tre mijë vjetëve, një popull i njohur me emrin dardanët, që ishin pjesë e grupit të fiseve të ilirëve apo thrakasëve, u vendosën në rrafshnaltën e Sjenicës dhe në rajonin përreth. Gjurmë të kulturës së tyre të Bërnjicës (varrime me djegie të kufomave) ende mund të identifikohen nga shek. VIII p.e.s. afër Sjenicës dhe më gjerësisht në luginën e lumenjve të Rashkës, Ibrit dhe Sitnicës.

Rreth mileniumit të parë p.e.s., grupe të ndryshme të ilirëve e zhvilluan një gjuhë dhe kulturë të përbashkët, e cila mbulonte rajonin që sot është Bosnja juglindore, Serbia jugperëndimore, gjysma e pjesës veriore të Shqipërisë dhe Malit të

Zi duke u zgjeruar deri në Epir dhe në Maqedoninë veriperëndimore. Mbetjet e shumë kështjellave të vogla në rrënjët e kodrave të shpërndara nëpër rajon, tregojnë se ka ekzistuar një kulturë luftarake që është zbatuar nga udhëheqësit fisnorë lokalë ku banorët shpesh janë detyruar të kërkojnë mbrojtje nga njeri-tjetri në këto vendbanime të fortifikuara.

Mes shekujve VI dhe IV p.e.s., anëtarë të një fisi tjetër ilir, autariatët, u vendosën në luginën e Rashkës dhe në rrafshnaltën e Peshterit, me gjasë duke u larguar kah jugu dardanët e mëhershëm. Hulumentimet e bëra në ato që duket se janë varreza të luftëtarëve autariatë në Glogovnik (Mal të Zi), sugjerojnë se ky grup formon një pjesë integrale të kulturës Glasinac, e cila gjatë Epokës së Hershme të Hekurit (shek. VIII-V, p.e.s.) është zgjeruar në një rajon



që ka përfshirë Bosnjën lindore, jugperëndimin e Serbisë, pjesë të Malit të Zi dhe Shqipërinë veriore. Afër Novi Pazarit, arkeologët kanë lokalizuar një ekzemplar të kulturës Glasinac që gjendet në themelet e kishës së shek. IX që quhet Petrova Crkva. Një varr, që mendohet se është i një luftëtari fisnik nga shek. VI p.e.s., është gjetur i pajisur me ar, argjend, stoli bronzi, maska qelibari, statuja të qeramikës, përfshirë figurat e zeza të enëve greke, që sugjerojnë se popullata vendase e kësaj kohe ishte në kontakt me Greqinë.

Tentimi i Justinianit për të rivënë qetësi dhe rindërtuar perandorinë, mezi mbijetoi gjatë jetës së tij pasi që kah mesi i shek. VI dhe përsëri në fillim të shek. VII, Ballkani edhe një herë u përfshi nga valët e invaduesëve. Këta ishin sllavët që filluan të migronin nga atdheu i tyre, diku

në Ukrainën e sotme, në rajonet e largëta të Danubit. Serbët, të shoqëruar nga avarët turkikë, që ishin më luftarakë, vazhduan të kërcënonin Kostandinopojën. Nën presionin e persianëve dhe për shkak të trazirave të brendshme, Perandoria Bizantine u detyrua të hiqte dorë nga posedimet perandorake në brendësinë e siujdhesës ballkanike.

Sllavët, përkundër avarëve, kishin ardhur për t'u vendosur e jo vetëm për të plaçkitur. Prandaj, u vendosën përgjatë rrugëve tranzitore romake dhe i okupuan rajonet e pëlleshme të luginave të lumenjve. Pa mbrojtjen e bizantinëve dhe duke mos qenë në gjendje të mbrohen vetë, popullata vendase u strehua në rajonet e largëta malore ku u morën me mënyrën e jetës pastorale dhe që e flisnin gjuhën e tyre që ishte një variant i latinishtes. / Telegrafi





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## KB Trepça fiton ndeshjen e parë në Ligën e Kampionëve

MITROVICË, 18 SHTATOR - Trepça ka fituar ndeshjen e parë kualifikuese në Ligën e Kampionëve. Në Antalya të Turqisë, mitrovicasit fituan ndaj skuadrës qipriote, Keravnos 82:79 (23:14, 21:30, 19:12, 19:23). Ndeshja ka qenë shumë interesante, duke u vendosur në çastet e fundit. Kampionët e Kosovës e nisën shumë më mirë ndeshjen, duke e fituar çerekun e parë 23:14, por kundërpërgjigja e qipriotëve nuk vonoi shumë. Pjesa e parë përfundoi

baras, 44:44. "Xehetarët" sërish ishin më të mirë në periodën e tretë, por Keravnos u rikthye, duke e bërë ndeshjen shumë interesante. Vendimtar ishte treshja e MVP së Superkupës, Desmond Cambridge për 80:79, kurse dy pikët nga Malik Johnson nga gjuajtja e lirë ngritën epërsinë në 82:79, derisa basketbollistët e Keravnos, në aksionin e fundit, tri herë tentuan për tri pikë, por pa sukses. Te Trepça u dalluan Mikailë Imusiq me 20 pikë

e gjashtë kërcime, Desmond Cambridge me 22 pikë dhe Samuel Hunter me 10 pikë e gjashtë kërcime. Trepça të premtën do të ndeshet me kampionin e Çekisë, Nymburk. Nëse arrin në finale, Trepça do të luajë përballë fituesit nga takimet në mes të: Kutaisi (Gjeorgji), Levice (Sllovakia) e Kalev/Cramo (Estoni). Në kualifikime janë 24 skuadra që do t'u bashkohen 28 skuadrave që tashmë janë përcaktuar për edicionin e ri.



## Drita fiton përballjen ndaj Malishevës

GJILAN, 18 SHTATOR - Skuadra e Ditës e ka fituar përballjen e Malishevës me rezultat 2-1. Kjo ndeshje është e mbetur nga java e parë në Superligën e Kosovës në futboll. Drita ishte skuadër me e mirë, duke rrëmbyer pikët e plota nga kjo ndeshje derbi. Vendasit realizuan golin e parë nëpërmjet Besnik Krasniqit, i cili në minutën e 24-të realizoi nga penalltia. Në pjesën e dytë, Drita realizoi edhe golin e dytë dhe me anë të Tushës, në minutën e 59-të. Mirëpo, Malisheva u mundua të rikthehet në lojë, por krejt çka arriti ishte goli i shënuar nga Aliu (79'). Pas kësaj ndeshje, Dita ka grumbulluar gjashtë pikë nga dy ndeshje të zhvilluara, derisa Malisheva ka dhjetë pikë në pesë ndeshje të zhvilluara. Në xhiron e Ditën e pret përballja derbi me Ballkanin në Gjilan, kurse Malisheva e pret në stadiumin "Liman Gegaj" skuadrën e Gjilanit.



### SHKURT

#### Ademi takon sekretarin e Federatës saudite, e falënderon për dhurimin e sistemit digjital

Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, është takuar sot me sekretarin e përgjithshëm të Federatës së Arabisë Saudite, Ibrahim Alkassim. Ai ka bërë me dije se Alkassim është njeriu që dhuroi programin digjital të kësaj federate për FFK-në. "Ky program do të implementohet në FFK, në lidhjet rajonale dhe në klube. Ky sistem digjital do ta përmirësojë komunikimin dhe do t'i lehtësojë procedurat administrative. I shpreh mirënjohjen time dhe të komunitetit të futbollit për këtë mbështetje të çmuar dhe e falënderova Federatën e Arabisë Saudite për angazhimin e saj në zhvillimin e futbollit në Kosovë", ka shkruar Ademi.

#### Skënderbeu paraqet Balajn

Liridon Balaj është zyrtarisht sulmues i Skënderbeut. Sulmuesi anësor u është bashkuar korçarëve si lojtar i lirë dhe tashmë do të jetë në urdhrat e trajnerit Ivan Gvozdenoviç për ta përforcuar repartin e avancuar. Gvozdenoviç kërkonte prej kohësh alternativa për Rashicën, Nikajn e Franklin, teksa tashmë ka siguruar firmën e një futbollisti i cili ka përvojë edhe në kampionate si ai zviceran dhe belg. Lojtari u është bashkuar në stërvitje korçarëve të cilët nëpërmjet rrjeteve sociale e kanë bërë zyrtare firmën me të. "Liridon Balaj zyrtarisht bardhekuq! 25-vjeçari i dalë nga academia e Besa Pejës, pas një karriere disavjeçare në Zvicër dhe Belgjikë, ka firmosur kontratën që e lidh me klubin për tri vitet e ardhshme!", thuhet në njoftimin e Skënderbeut.

#### Asani: Përgjegjësi shumë herë më të madhe kur luaj për Kombëtaren

Sulmuesi i Kombëtares shqiptare, Jasir Asani, ka shënuar tre gola dhe ka dhënë një asistim kundër Jokohamas në ndeshjen e vlefshme për Ligën e Kampionëve të Azisë. Kjo është tripleta e dytë në karrierë e Asanit me klubin e Guangjusë, pasi ka realizuar edhe një tjetër më herët, përkatësisht në mars të vitit 2023, ku Jasiri sapo kishte nisur aventurën në Korenë e Jugut dhe e kreu atë në ndeshjen kundër Incheon. Pas ndeshjes, ylli kuqezi u shpreh i lumtur. "Është ëndrra e çdo lojtari që ta përfaqësojë vendin në arena të mëdha. Prandaj unë kam një ndjenjë përgjegjësie shumë herë më të madhe kur luaj për Kombëtaren time të Shqipëria. Guangzhu kishte gjithashtu, ndeshjen e parë historike. Në këtë ndeshje fitorja erdhi nga të gjithë, jo vetëm nga unë. Kemi punuar së bashku. Forca ime është i gjithë grupi, të gjithë shokët e ekipit. Duhet të vazhdojmë të luajmë kështu", ka thënë Asani.



## Roma shkarkon De Rossin

ROMË, 18 SHTATOR - Tri pikë në katër javë i qëndrojnë ngushtë një ekipi si Roma, nuk shpëtojnë dot as një legjendë si Daniele De Rossi. Në mënyrë befasuese, klubi kryeqytetas shkarkon teknikun italian pas vetëm katër javësh. "Klubi i Romës

njofton se ka zgjidhur kontratën me Daniele De Rossin. Vendimi i klubit ka të bëjë me interesat e skuadrës, në mënyrë që të ringrihem në një moment kur është ende fillimi i sezonit. Daniele do të jetë përgjithmonë pjesë e shtëpisë. Klubi e falënderon

për punën e bërë në këto muaj me pasion dhe vendosmëri", thuhet në njoftimin e klubit kryeqytetas. De Rossi zbankoi te Roma një vit më parë, pas largimit të Jose Mourinhos, një lëvizje kjo e drejtuesve që zbuti shumë shkarkimin e teknikut

portugez. Ish-kapiteni dukej si një bekim, por në fund të sezonit doli "duar bosh", pa trofe, ndërsa nuk arriti ta kualifikojë ekipin as në Ligën e Kampionëve. Ky fillim sezoni, me tri barazime në katër javë, rezultoi përcaktues për fatin e tij.



## Kompany: Jam djali i një refugjati, tani jam trajner i Bayernit

MUNCHEN, 18 SHTATOR - Legjenda belge Vincent Kompany filloi me sukses ndeshjen e tij të parë si trajner i Bayern Munchenit në Ligën e Kampionëve. Bayerni e mposhti Dinamon e Zagrebit me rezultat të thellë 9-2 në ndeshjen e parë të sezonit në fazën e grupeve. Pas ndeshjes, Kompany shfrytëzoi mundësinë për të ndarë diçka personale nga jeta e tij si përgjigje ndaj atyre që kanë sugjeruar se ai nuk është gati për një klub të madh si Bayerni. "Do t'ju them diçka në mënyrë të shpejtë vetëm për të vërtetuar një pikë", ka thënë fillimisht legjenda e Manchester Cityt. "Kam lindur në Bruksel. Babai im ishte një refugjat i ardhur nga Kongo. Cilat janë shanset e mia për të luajtur në Ligën Premierë, për të fituar diçka si lojtar, për të luajtur për kombëtaren? Shanset ishin 0.000. Tani unë jam trajner në Bayern", ka thënë Kompany. "A ndaloni së besuari në veten tuaj dhe atë që mund të arrini për shkak të asaj



që thonë njerëzit e tjerë. Mentaliteti është të vazhdosh dhe në fund, nëse dështon, dështon, nëse ia del mbanë, ia del, por gjithmonë mund të bëhesh më i mirë", ka shtuar ai. "Në rrjetet sociale gjithmonë mund të gesh gjëra, kështu që unë nuk e marr me të vërtetë

personale", ka përfunduar Kompany. Ai ka fituar katër herë Ligën Premierë me Cityn, përveç dy Kupave FA dhe dy Kupave të Ligës. Ndërmarrja e këtij hapi drejt menaxhimit nga të qenit një lojtar yll ka filluar me një zhurmë por, si duket, shpejt do të mësohen me sukseset e tij.

## Te Ferrari besojnë te titulli: Edhe ne mund të shpallemi kampionë këtë sezon

MARANELLO, 18 SHTATOR - Në Azerbajxhan, Ferrari iu afrua fitores së dytë radhazi, por në fund ishte McLaren ai që triumfoi. Megjithatë, Frederic Vasseur konfirmon përshtypjen se "kokëkuqja" ishte makina që duhej mposhtur në Baku dhe kërkon fitoren këtë fundjavë në Singapor. Jo vetëm kaq, por ai mendon se disavantazhi prej 51 pikësh nga McLaren, që udhëheq renditjen, është plotësisht irikuperueshëm. "Historia mund të jetë ndryshe në Singapor, sepse lloji i këndeve do të jetë i ngjashëm, por me shumë më tepër forcë. Pas Singaporitdo të kemi një pushim para Austin", ka thënë Vasseur. "Dua një rezultat të mirë në Singapor, siç bëjmë vitin e kaluar. Jemi në një moment të mirë dhe duhet të vazhdojmë kështu për të mbledhur sa më shumë pikë", ka shtuar shefi i



Ferrarit. "Do të ketë ulje-ngritje deri në fund të sezonit. Ajo që ka rëndësi është të fitosh kur je në formë të mirë, por edhe të marrësh pikëkur nuk je. Në këtë kemi dështuar në Kanada, Angli

dhe Austri. Ne jemi sërish të aftë dhe në gjendje të luftojmë për pole dhe fitore çdo fundjavë. Ka ende 300 pikë në dispozicion. Gjithçka është e mundur, do të jetë një luftë e gjatë", ka deklaruar Vasseur.

### SHKURT

#### Ndërron jetë legjenda e futbollit italian Schillaci

Bota e futbollit sot mori një lajm të hidhur. Ka vdekur legjenda e futbollit italian, Salvatore "Toto" Schillaci. 59-vjeçari luajti për skuadra të njohura Inter, Messina dhe Juventus. Ai dha kontribut të madh për Kombëtaren e Italisë. Gjatë karrierës së tij ai zhvilloi 384 ndeshje, shënoi 159 gola dhe bëri 19 asistime. "Toto" para disa muajsh ishte edhe në Kosovë, ku ishte hapur ekspozita e legjendës Paolo Rossi.

#### Arrestohet dhe lirohet kampioni i boksit Oleksandr Usyk

Kampioni absolut i botës në boks, ukrainasi Oleksandr Usyk (37), u arrestua në aeroportin e Krakovit, ndërsa video e arrestimit u shfaq në rrjetet sociale. Sipas ESPN amerikane, Usyk planifikoi të fluturonte për në Valencia (Spanjë), ku dëshiron të përgatitet për revanshin kundër Tyson Fury (36) në Riad më 21 dhjetor (Arabia Saudite). Ukrainasi u ndalua në rrethana të paqarta dhe më pas u deklarua se ishte një keqkuptim. Një video e publikuar në rrjetet sociale tregon Usykun duke u larguar me pranga nga oficerët e policisë. Edhe presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ndërhyri menjëherë në këtë rast, pas së cilës Usyk u la i lirë. "Kishte një keqkuptim. Gjithçka u zgjidh shpejt. Faleminderit të gjithëve që u kujdesën! Faleminderit diplomatëve ukrainas për mbështetjen e tyre efektive!", shkroi Usyk në "Twitter", por nuk zbuloi pse u arrestua.

#### Ancelotti: Në Ligën e Kampionëve nuk mund të fitosh pa vuajtur

Kampionët e Real Madridit në Ligën e Kampionëve e mposhtën Stuttgartin me rezultat 3-1. Trajneri Carlo Ancelotti ka thënë se ndeshje të tilla janë vështirë për t'u fituar, sidomos në garën më të fortë në futboll. "Ne jemi ende duke punuar shumë për të qenë versioni më i mirë i vetes sonë. Pas barazimit ne treguam forcën për t'u mos u dorëzuar dhe arritëm të fitonim. Nëse dikush mendon se të fitosh të tilla ndeshje është e thjeshtë, gabohet rëndë. Kam drejtuar skuadrat e mia në rreth 200 ndeshje në Ligën e Kampionëve dhe në asnjërën prej tyre nuk mbaj mend të mos kemi vuajtur për ta marrë rezultatit", ka thënë Ancelotti.

#### Mulleri kalon Xavin

Sulmuesi veteran Thomas Muller vazhdon të vendosë rekorde në fushën e blertë me fanellën e Bayern Munchenit. 35-vjeçari me ndeshjen kundër Dinamos së Zagrebit (e fituar me rezultatit e thellë 9-2), grumbulloi paraqitjen e tij të 152-të në Ligën e Kampionëve me fanellën e gjigantëve gjermanë. Mulleri theu rekordin që i përkiste Xavit, atë të më shumë paraqitjeve në Ligën e Kampionëve me të njëjtën fanellë. Spanjollli me fanellën e Barcelonës ishte ndalur në 151 paraqitje.

## Zyrtare: Martial, futbollist i ri i AEK-ut

Anthony Martial është zyrtarisht lojtari më i ri i AEK Athinës, i cili iu bashkua klubit grek si lojtar i lirë. Sulmuesi francez u largua nga


Manchester Unitedi pas skadimit të kontratës së tij këtë verë pas plot nëntë vitesh në "Old Trafford". Megjithatë, nuk ka vonuar shumë dhe Martial

ka gjetur tashmë klubin e ri, i cili tashmë e ka zyrtarizuar transferimin e tij. Bëhet fjalë për grekët e AEK-ut të Athinës, klubi i cili ka njoftuar ardhjen e

28-vjeçari, i cili do të mbërrijë në Greqi këtë të mërkurë për t'i kryer formalitetet. "Magjistari po vjen!!! Takimi ne aeroport!!! Koha 20:40", thuhet në

njoftimin e AEK-ut. Martial thuhet se ka nënshkruar një kontratë deri në vitin 2027 dhe do të bëhet një nga lojtarët e tyre më të paguar.





# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](https://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Lindja Solar" L.L.C. Brestovc, Rahovec në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parkun solar fotovoltaik me kapacitet 100 MW në Kramovik dhe Petkoviq, Komuna e Rahovecit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 01.11.2024 në ora 10:00 në objektin e komunës së Rahovecit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Lindja Solar" L.L.C. Brestovc, Rahovec, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Parkun solar fotovoltaik me kapacitet 100 MW në Kramovik dhe Petkoviq, Komuna e Rahovecit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Join Zoom Meeting#

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Lindja Solar" L.L.C. Brestovc, Rahovec, për Parkun solar fotovoltaik me kapacitet 100 MW në Kramovik dhe Petkoviq, Komuna e Rahovecit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [ynm.komente@rks-gov.net](mailto:ynm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Belona Stublla shpall të pavlefshme dëftesën e SHFMU "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Belona Stublla shpall të pavlefshme dëftesën e klasës -X-, -XI- të Gjmnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Pranvera Kërshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SHME "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Egzon Nagavci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës -X- të shkollës SH.M.T. "Nexhmendin Nixha", Gjakovë.

- Mentor Hakif Mustafa shpall të pavlefshme certifikatën me nr. 50/2005 të lëshuar nga Qendra e Aftësimi Profesional në Mitrovicë, ndërtimtari, organizim të punës, siguri punës, vizatim teknik, matjen e objektit, betonim, muratim, suvatim.

- Qerfime Rama shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Xhevat Jusufi" ish shkolla fillore "Rifat Vidishiqi".

- Bedrije Deliu shpall të pavlefshme 3 dëftesat e shkollës së mesme "Frang Bardhi".

- Alban Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari".

- Zana Rama nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4. dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.



## Në kujtim të më të dashurit tonë

**Shejh Salih (Ibrahim) Muçaj**

(07.07.1949- 19.09.2012)

Dymbëdhjetë vite kaluan, malli dhe nostalgjia për ty po na rëndojnë çdo ditë e më shumë.  
Kaloj kohë e gjatë pa ngrohtësinë tënde, por nuri yt na bën dritë në çdo hap të jetës.  
Ishe strehë e zemrave nevojtare, atëdhedashës, e i paepur për punë.  
Duke ecur rruges që na le pas, e kuptuam më së miri që nuk ishe vetëm i familjes, por i të gjithë atyre që gjetën vetën tek ti.  
Të pa harruara do të mbetën ditët që i kaluam me ty, e krenarë pafundësisht që jemi bimë e jotja.

**Të përkujtojmë me dashuri dhe rrespekt të përjetshëm:**

Bashkëshortja: Naxhija.

Djeme: Shejh Xhemajliu, Hyseni, Shabani.

Rejat: Mirjeta, Teuta, Dardana, Aldonita.

Nipat: Ibrahim, Muhamed Mehdiu, Salihi dhe Moni.

Mbesat: Arbbesa, Agnesa, Naxhija, Tringa, Bora dhe Aorta e vogël!





# TRADITË QË NGA

# 1992









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

